



KUVENDI

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 30 qershor 2017, në mbledhjen e XLIII-të (dyzetetere) të Kuvendit të Komunës.

Mbledhja filloi në orën 10;10 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z.Mehmet Gashi, Kryesues Kuvendit.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët e Kuvendit, përveç z.Avni Ajeti, i cili mungoi.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje të pranishëm ishin, z.Nexhmi Rudari Nënkryetar i Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës, z.Muharrem Haziri përfaqësues i OSBE - së, përfaqësues të KFOR-it, disa përfaqësues të mjeteve të informimit, dhe një numër i qytetarëve.

1. Miratimi i rendit të ditës

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi seancën, përshëndeti të pranishmit dhe në vazhdim konstatoi prezencën ku fillimisht për z.Avni Ajetin tha se mungon me arsye dhe për këtë më ka paralajmëruar, ndërsa për znj.Florije Maliqi, znj.Kadrije Mulolli dhe znj.Tringa Sfishta tha se për momentin nuk janë prezent por të shohim në vazhdim të mbledhjes a do vijnë apo jo. Konsideroj që materiali për këtë mbledhje duke përfshirë edhe CD-n për pikën e 6 të rendit të propozuar të ditës ju është dërguar me kohë, po ashtu edhe konstatimet nga mbledhja e Komitetit për Politik dhe Financa – KPF ju janë shpërndarë.

Vlen të theksohet se në këtë mbledhje prezent është edhe z.Fidan Rekaliu i cili ndoshta është në mbledhjen e fundit të tij për këtë mandat të Kuvendit të Komunës sepse sipas të gjitha gjasave është zgjedh deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, gjë për të cilën në emrin tim dhe në emër të Kuvendit e uroj për zgjedhjen deputet dhe i uroj suksese, mirëpo meqë se ende nuk është bërë certifikimi i rezultateve nga KQZ, besoj se nuk ka pengesa sa i përket pjesëmarrjes në këtë mbledhje, ndërsa posa të bëhet certifikimi i rezultateve ne do t'i zhvillojmë procedurat për zëvendësimin e këshilltarit të cekur.

E hapi mbledhjen.

znj.Kumrie Hoti, theksoi, në seancën e datës 28.12.2016 kur është miratuar plani i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2017, kam kërkuar që në gjashtëmujorin e parë të vitit në atë plan të përfshihet një informatë rreth shëndetësisë, informat e cila është përfshirë në plan, por që ende nuk është sjellë në Kuvend, vërejtje të cilën e kam paraqitë edhe dje në mbledhjen e KPF-së, kështu që kërkoj nga drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale - DSHMS të kemi një informatë rreth kujdesit primar shëndetësorë sepse është viti i katërt me radhë që e kërkoj një informatë të tillë, por që drejtori i cekur nuk e ka sjellë asnjëherë. Pra duke qenë në dijeni për gjendjen dhe rrethanat e

shëndetësisë në Komunën e Podujevës, kërkoj që në seancën e radhës, në kuadër të rendit të ditës të kemi një pikë për kujdesin primar shëndetësorë.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, drejtori i DSHMS-së është zyrtarisht në Prishtinë dhe ka kërkuar ndjesë që nuk është prezent në këtë mbledhje mirëpo e vërteta është se këshilltarja parafolëse edhe dje në mbledhjen e KPF-së e ka paraqitur një kërkesë të tillë dhe drejtori në fjalë ishte prezent në KPF dhe i ka dhënë arsyet pse nuk kemi një informatë të tillë në këtë mbledhje, mirëpo i njëjti ka thënë se në mbledhjen e radhës do të sjellët informata e kërkuar. Andaj meqë nuk ka këshilltarë tjerë të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedh në votim rendin e propozuar të ditës sipas materialit përkatës.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës sipas materialeve të propozuara.

2. Ekstraktet e Procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më 03 maj 2017 dhe 26 maj 2017

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, i kemi dy Ekstrakte të procesverbaleve nga mbledhjet paraprake të cilat sigurisht që i keni lexuar, andaj nëse ndokush nga këshilltarët ka ndonjë vërejtje apo diçka të paqartë, mund t'i paraqet ato, nëse jo atëherë i hedh në votim këto dy Ekstrakte të procesverbaleve nga mbledhjet paraprake të Kuvendit.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratuan;

-Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 03 maj 2017,

-Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 26 maj 2017

3. Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) e Komunës së Podujevës 2018 - 2020

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit, e ftoj drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave që të paraqesë një fjalë hyrëse rreth kësaj pike.

z.Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave (DBF), e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Podujevës për vitet 2018 – 2020 është pjesë përbërëse e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve – KASH të Republikës së Kosovës dhe është e hartuar në përputhje me procedurat buxhetore për vitet 2018 – 2020 të dhëna nga Ministria e Financave përmes Qarkores Buxhetore 2018/01.

Me këtë dokument janë përcaktuar kufijtë buxhetor fillestar për Komunën e Podujevës në vlerë prej 20,748,507.00€ për vitin 2018, dhe atë duke u ndarë; në grantin e administratës së përgjithshme 7,979,781.00€, granti për arsim 8,792,462.00€, granti për shëndetësi 2,411,000.00€ si dhe të hyrat vetanake të planifikuara të Komunës së Podujevës për këtë periudhë 1,557,614.00€. Nëse krahasojmë buxhetin aktual të vitit 2017, me këtë dokument kemi një ngritje të buxhetit prej rreth 1,465,000.00€.

Gjithashtu KAB paraqet një mjet të procesit të zhvillimit të buxhetit që bënë ndërlidhjen e resurseve në dispozicion për prioritetet e Komunës duke u bazuar në qëndrueshmërinë e

programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme trevjeçare, dokument në të cilin po ashtu paraqiten shpjegime, politika dhe prioritete të tanishme dhe afatmesme të Komunës së Podujevës si dhe projeksione lidhur me mënyrën me të cilën buxheti i Komunës do të përmbush projektet më prioritare sipas buxhetit për vitet 2018 – 2020, gjithashtu në këtë dokument kornizë janë paraqitur edhe objektivat të cilat synohen të arrihen gjatë kësaj periudhe, dhe atë; krijimin e një ambienti të përshtatshëm për biznes, zhvillim i qëndrueshëm i bujqësisë dhe fshatrave, zhvillim i qëndrueshëm hapësinor dhe urban, përmirësim i infrastrukturës fizike, përmirësim i shërbimeve shëndetësore dhe mirëqenies sociale, sigurim dhe ngritje të cilësisë në arsim.

KAB reflekton perspektivën e politikave makrofikale si vijon; parashikimin e të hyrave komunale sipas llojeve të të hyrave, sipas parashikimeve të shpenzimeve buxhetore dhe sipas programeve dhe kategorive ekonomike, ku përmes këtij dokumenti jemi munduar të paraqesim në mënyrë të qartë deklaratën e aktiviteteve, misionin dhe objektivat e Komunës për secilën Drejtori e cila përmban përmbledhjen e aktiviteteve të nevojshme për të arritur misionet dhe qëllimet e tyre, strategji për të arritur aktivitetet e nevojshme, një vlerësim të rreziqeve gjatë periudhës buxhetore dhe një adresim të përgjithshëm për t'i adresuar rreziqet. Po ashtu secila Drejtori ka një sesion të veçantë për matje të performancës që përshtatet në një deklaratë të misionit, deklaratën e vizionit dhe deklaratën e qëllimit. Në fushën e shpenzimeve të KAB është përfshirë një projeksion trevjeçar i shpenzimeve që mund të financohen nga granti qeveritar dhe nga të hyrat vetanake, shpenzime të cilat janë të projektuara sipas Drejtorive, programeve dhe objektit të shpenzimeve siç janë; paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, komunal, subvencione dhe kapitale, shpenzime këto të ndara sipas përqindjes së paraparë për vitin buxhetor 2018 dhe projeksioneve për vitet 2019 – 2020, ku çdo Drejtori ka një performancë ku përfshihen masat e arsyeshme të cilat mund edhe të përmirësohen dhe që janë indikator i vërtetë i performancës.

KAB ka një seksion për projektet për investime publike komunale PIP në një periudhë trevjeçare ku përfshihet edhe lista e projekteve kapitale të cilat mendojmë të implementohen me financim nga granti qeveritar dhe nga të hyrat vetanake pa e përjashtuar edhe mundësinë e financimit nga donatorë të ndryshëm qoftë brendshëm qoftë të jashtëm. Ky dokument i KAB është hartuar fillimisht në bazë të kufijve fillestar sipas Qarkores buxhetore 2018/01 ku pastaj do të pasojnë edhe qarkore tjera me të cilat do të përcaktohet buxheti final i Komunës për vitin 2018 dhe projeksionet për vitet 2019 – 2020, duke mbetur me shpresë që me qarkoret tjera të radhës do të kemi një buxhet më të favorshëm për Komunën e Podujevës, ju ftoj ta miratoni Kornizën Afatmesme Buxhetore 2018 – 2020 të Komunës së Podujevës.

Kryesues i Kuvendit, e falënderoi drejtorin parafolës për mënyrën e qartë të prezantimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Podujevës për periudhën 2018 – 2020.

z.Hasan Softolli, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrahim Kornizën Afatmesme Buxhetore - KAB 2018 – 2020, dokument ky i cili paraqet projeksionet e qeverisjes komunale për periudhën e ardhshme trevjeçare, dhe në të cilën janë paraparë të hyrat të cilat edhe janë të shpalosura sa i përket burimeve të buxhetit, dhe janë të shtjelluara në kategori të ndryshme të shpenzimeve dhe Drejtorive përkatëse. Në përgjithësi KAB 2018 - 2020 paraqet projekte të mira për qytetarët, posaçërisht Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit e cila vazhdimisht ka një buxhet të mirë e që vlen të ceket se kemi vazhdimin e ndërtimit të bulevardit - sheshit të Dëshmorëve si dhe një projekt shumë i rëndësishëm që është planifikuar, ndërtimi i

garazheve nëntokësore, i cili sigurisht se do të jetë ndihmë e madhe për qytetin tonë, mandej vlen të theksohet nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale kemi projektin për ndërtimin e një qendre emergjente, që mendoj se është shumë e domosdoshme për banorët e Komunës së Podujevës, pra këto janë vetëm disa nga projektet e mira të Komunës por në përgjithësi mendoj se projekte të tilla ka edhe në të gjitha Drejtoritë tjera të Komunës. Gjithashtu karakteristikë e kësaj Kornize është edhe rritja reale e ekonomisë në nivel të përgjithshëm rreth 4%, e që ndikon edhe në rritjen e investimeve tek ne në Komunën e Podujevës. Po ashtu ne jemi në dijeni se kërkesat janë të mëdha për investime dhe ky buxhet nuk është i mjaftueshëm për përmbushjen e të gjitha atyre, por konsideroj se Ekzekutivi i Komunës e ka paraparë mënyrën më të mirë të mundshme të shpërndarjes së këtij buxheti.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, duke mos dashur ta zgjati shumë diskutimin tim sepse ky dokument do të zbatohet nga qeverisja e ardhshme, t'ju them të drejtën edhe pse Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit në pikën 6 të këtij dokumenti për vitin 2019 ka përfshirë disa rrugë në fshatin Lluga, konkretisht në Lagjet Çunaku dhe Zhitia, e që realisht janë projekte që parashihen qe tri vite me radhë por që të njëjtat kanë lëvizur vazhdimisht, do të ishte mirë që drejtori i asaj Drejtorie ta ketë parasysh këtë projekt në mënyrë që për hir të transparencës dhe qytetarëve ai projekt me rishikimin e buxhetit apo ndonjë formë tjetër të hynë dhe të realizohet më herët se viti 2019, pra është paraparë ai projekt dhe janë ndarë 60,000.00€ por që mendoj se është vonë që ai projekt të kryhet në vitin 2019, andaj kërkoj që ai projekt të kryhet më herët sepse që nga viti 2014 ka pasur kërkesa për ato dy rrugë të Lagjeve të cekura por që vazhdimisht ka lëvizë si projekt dhe për këtë jam në dijeni se nganjëherë hapësira kohore qon peshë tek qytetarët, por jo edhe tek Drejtoria. Ky dokument mund të ndryshohet nga qeverisja e ardhshme e Komunës, por ajo që vlen të ceket është se përshtypje më ka bërë edhe një çështje tek Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik – DPZHE dhe që më është dukur paksa interesante parashikimi i Drejtorisë se si do ta zhvilloj Komunën, ndoshta për drejtorin e DPZHE janë shumë të arsyeshme por unë mendoj se me ndërtimin e shtigjeve për ecje nuk zhvillohet Komuna sepse nga kjo nuk mund të krijohen të hyra, pra rreth 15,000.00€ të parapara për këtë çështje është shumë interesante, pastaj ndërtimi i shtigjeve për biçikleta në parkun e qytetit në shumë 6,000.00€ po ashtu nuk e zhvillon ekonomikisht Komunën sepse nuk krijohen të hyra nga ky projekt, mandej kemi shumën e paraparë prej 10,000.00€ për ndërtimi i inkubatorit të biznesit, e që mendoj se me këtë shumë nuk mund të ndërtohet madje edhe një shtëpi sa do e vogël. Prandaj i them këto gjëra sepse në qoftë se është menduar të zhvillohet Komuna është dashur të ngritën të hyrat në DPZHE, gjë për të cilën mendoj se këtu prezent kemi këshilltarë të Kuvendit të cilët e njohin më shumë fushën e biznesit, por unë po e shprehë vetëm një mendim timin dhe jam shumë i sigurt se me 10,000.00€ nuk mund të bëhet një inkubator i biznesit ashtu sikurse që jam shumë i sigurt se me ngritjen e shtigjeve për ecje dhe për biçikleta nuk mund të zhvillohet Komuna, mirëpo DPZHE është dashur që të paktën të vie me dy projekte konkrete për vitet 2018 – 2020 duke përllogaritu se sa do të zhvillohet Komuna dhe sa do të jenë të hyrat nga ato programe të cilat vet ajo Drejtoria do t'i parashihte, pastaj sa donatorë të huaj por edhe vendor duke përfshirë edhe Partneritetin Publiko Privat, do të fokusoheshin në programin e DPZHE. Po ashtu Drejtoria e Administratës ka paraparë 8,000.00€ në vitin 2019 për funksionim të administratës, ne edhe pse jemi në dijeni se është duke u ndërtuar objekti i ri, në një formë këtu në këtë sallë dhe në këtë ambient mendoj se në mënyrën më të dobët e kemi kaluar

këtë mandat 4 vjeçar, pa klimë-ajrosje etj. ndërsa Drejtoria e Administratës e fut në programin e saj hapjen e një pusi në fshatin Orllan dhe vendosjen e grilave në Zyrën e Vendit, për mua ky drejtor nuk ka vizion për ta udhëhequr Drejtorinë e Administratës, madje mua personalisht do të më vinte turp që për vitin 2019 të sjell një propozim të tillë para këshilltarëve të këtij Kuvendi dhe para të pranishmëve tjerë këtu. Dua të them se propozimet e këtyre dy Drejtorive duhet të shqyrtohen, jo që e rëndojnë buxhetin, por për mendimin tim janë asgjë përveç sa për të thënë se ka planifikime, përndryshe Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit si dhe Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit i kanë disa projekte konkrete për të cilat ndoshta kemi ndonjë vërejtje të vogël për lëvizje apo realizim të tyre sa më shpejt për hir të aspekteve kohore. Ne do ta japim mbështetjen për këtë dokument që i njëjti të vazhdoj në vitin 2018 mirëpo jam skeptik paksa për implementimin, kushdo që të jetë në pushtetin e ardhshëm, thënë të drejtën po të isha unë Kryetar i Komunës nuk do ta mbaja në punë drejtorin e Drejtorisë së Administratës dhe ta paguaja për 12 muaj në vit, i cili po e përsëris se e ka sjell një propozim të tillë për vitin 2019, po ashtu nuk do ta mbaja drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik – DPZHE i cili sjellë propozim për ndërtimin e shtigjeve për ecje dhe për biçikleta, për arsye se i njëjti më shumë paguhet për një vit sesa që bën zhvillimin e Komunës apo që sjellë të hyra për Komunën. Nuk i them këto gjëra veç pse jam nga një subjekt tjetër politik sepse po të ishte ashtu do të thoja edhe për drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit i cili realisht ka paraparë disa projekte të cilat nuk mund të kontestohen. Vlen të ceket se në vitin 2014 ish drejtori i DPZHE z.Avni Fetahu pati sjellë të njëjtat propozime për shtigje për ecje dhe biçikleta dhe tani më bëri përshtypje se si edhe drejtori aktual ka vazhduar me të njëjtat propozime.

Kryesuesi i Kuvendit, sa për konstatim të prezencës, thekson se përveç z.Avni Ajetit, të gjithë këshilltarët tjerë janë prezent në sallë.

z.Haki Rudari, theksoi, është një fjalë popullore ku thuhet “me fol kah del gjuha” mirëpo unë sot po foli me zemër për arsye se vërtetë kur po flas me zemër gjërat po janë shumë më reale dhe më të mira. Realisht sot po e analizojmë dhe po diskutojmë për një dokument për të cilin do të jetë një përbërje e re e Kuvendit të Komunës dhe do të kemi një qeveri të re dhe shpresoj të jetë një parti e re në pushtet në vitin e ardhshëm, andaj sigurisht që duhet të jemi të kujdesshëm me këto projekte dhe në këtë drejtim vijnë edhe vërejtjet e Grupit të këshilltarëve nga radhët e LVV-së që për ne KAB 2018 – 2020 paraqet një dokument të rëndësishëm për Komunën ku mënyra e planifikimit, menaxhimit dhe shpërndarjes së buxheti ndikon drejtpërdrejtë në mirëqenien e qytetarëve dhe të Komunës sonë në aspektin e tërësishëm të zhvillimit ekonomik e që deri tani ka munguar. Lëvizja Vetëvendosje – qendra në Podujevë së bashku me grupin e ekspertëve ka shqyrtuar dhe analizuar me kujdes të veçantë këtë dokument e në veçanti projektet ose kodet buxhetore të Drejtorive, dhe një konstatim i përgjithshëm është se këto kërkesa të cilat janë në këtë dokument nuk i përkasin, nuk i mbulojnë dhe nuk i arsyetojnë kërkesat e qytetarëve në vende të ndryshme për arsye se edhe përkundër asaj që kanë përfunduar zgjedhjet qendrore, ne si Grup i këshilltarëve të LVV-së vazhdimisht jemi nëpër terren duke komunikuar me qytetarë të ndryshëm gjë e cila tregon se ky bashkëbisedim dhe ky komunikim me qytetarët po del të jetë i frytshëm. KAB 2018 – 2020 e Komunës së Podujevës është hartuar dhe planifikuar në mënyrë jo të mirë, me një pjesëmarrje të vogël të qytetarëve dhe shumë pak transparent, po ashtu ndarja e buxhetit nuk mbulon nevojat dhe kërkesat e qytetarëve në zona të caktuara, prandaj për ne LVV-në është mjaft me

rëndësi se kudo që janë projektet e qytetarëve të merren parasysh dhe mos të vihen në lajthitje sidomos fjala është për ata qytetarë të cilët që dy-tri vite kanë hartuar dhe dorëzuar projekte dhe të njëjtat fare nuk merren për bazë nga qeveria komunale, gjë e cila nuk bënë të ndodh, ndërsa me një qeveri të udhëhequr nga LVV-ja kjo nuk do të vinte në shprehje aspak. Gjithashtu ky dokument edhe në aspektin teknik nuk ka dhënë sqarimet e nevojshme për përfundimet e projekteve të ndryshme dhe në shumë raste më shumë thuhet vazhdim i projekteve pa e sqaruar se për cilat projekte bëhet fjalë. Në rast se hym dhe analizojmë projekte të ndryshme, unë e posedoj edhe KAB 2017 – 2019 të Komunës së Podujevës në të cilën është paraparë të kemi një investim prej rreth 1 milion euro për ndërtimin e bulevardit dhe sheshit të Dëshmorëve në qytet, gjë e cila nuk ka ndodhur, madje nga ai projekt në këtë vit janë marrë 930,000.00€ të cilat janë rialokuar në 20 kode të reja e që për ne LVV-në edhe atëherë por edhe tani mbetet e papranueshme sepse projektet nëpër Drejtori po kalkulohej dhe po hiqen, andaj meqë është një dokument shumë i rëndësishëm, ne duhet t'i përmbahemi projekteve dhe investimeve të parapara e jo të bëhen lëvizje të projekteve dhe shumave të parapara. Të njëjtin rast e kemi edhe tek Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ku në KAB 2017 – 2019 ka qenë e paraparë blerja e një kombibusi për bartjen e pacientëve me dializë në shumë 32,292.00€, projekt ky i cili është bartur edhe në KAB 2018 – 2020, gjëra të cilat mendoj se nuk duhet të përsëriten dhe janë gjëra të cilat paraqesin një jo seriozitet të qeverisë lokale dhe kjo ndodh si mungesë e një programi qeverisës të cilin ne vazhdimisht e kemi kërkuar, dhe si pasojë e kësaj pastaj vijmë deri tek lëvizjet ose bartjet e projekteve të ndryshme. Në rast se hym dhe analizojmë në KAB 2018 – 2020, vërtetë kemi disa kode të cilat për ne janë të papranueshme ndonëse në parim jemi për investime çfarëdo qofshin ato, edhe pse ky buxhet është i kanalizimit dhe i asfaltit, që edhe aty duhet të investohet por nuk duhet lihet mbrapa zhvillimi ekonomik, turizmi etj. Tek Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, ajo që për ne është sërish indikatorë është se në vitin 2018 sërish kemi një shumë prej rreth 1 milion euro për ndërtimin e sheshit të Dëshmorëve, andaj për këtë shtroj pyetje, a mund të ndodh që në vitin 2018 sërish të hiqet kjo shumë dhe të bartet në kode tjera, apo si do të jetë kjo, çështje për të cilën e kam thënë dhe po e përsëris prap se është turp për ne në përgjithësi e sidomos për partinë në pushtet që ende që 17 vite Komuna e Podujevës nuk e ka një bulevard të Dëshmorëve ashtu siç e kanë shumica e Komunave tjera, projekt ky i cili ka qenë i paraparë të ndërtohet në vitin 2017 e që është hequr, dhe tani është paraparë për vitin 2018, andaj shtrohet pyetja, a mund të ndodh të hiqet sërish ai projekt edhe në vitin 2018. Çështje tjetër në këtë dokument po ashtu është se kemi emërtime vetëm, asfaltim i disa rrugëve, pa specifikuar se për ku dhe si është fjala, dhe gjatë debateve që kemi me qytetarë nuk mund të ndajmë mendime se ku dhe si bëhen investimet ngase nuk bëhen specifikime dhe nuk e di pse bëhet kjo sepse do të duhej të dihet se në cilin fshat është projekti, pastaj rruga, pjesa apo në qytet e kështu me radhë. Po ashtu tek cilësia e punimeve ka raste që për një kohë shumë të shkurtër ka prishje ose dëmtim të asfaltit gjë e cila mendoj se është përgjegjësi e qeverisë lokale përkatësisht e komisioneve të pranimit, por në të njëjtën kohë po kemi dëmtim të asfaltit edhe nga ana e qytetarëve të ndryshëm të pandërgjegjshëm gjë për të cilën Drejtoria e Inspeksionit duhet të jetë shumë më aktive. Dua të ngrisë një çështje e cila ka të bëjë me një rrugë rreth 10 metra në fshatin Gllamnik e cila ka mbet pa rregulluar dhe kur ka të reshura aty bëhet një lloj moçali, andaj mendoj se nuk janë fajtorë qytetarët dhe nxënësit për atë rrugë por në bazë të informatave fajtor kanë qenë penguesit që e kanë penguar asfaltimin e asaj rruge.

Sa i përket Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSH, një shumë e mjeteve prej rreth 132,000.00€ është për rindërtimin e ndriçimit publik, dhe për këtë shtroj pyetje, për cilën rrugë, lagje apo fshat bëhet fjalë, pastaj figuron projekti për zgjerimin dhe rregullimin e shtretërve të lumenjve por që as për këtë projekt nuk ka specifikime dhe është mirë të specifikohen se për cilët lumenj dhe për cilat pjesë bëhet fjalë, mandej për riparimin e rrugëve të asfaltuara kemi shumë rreth 38,000.00€, mirëpo unë mendoj se është mirë që si qeverisje lokale vërtetë të jemi serioz me përfundimin e projekteve sepse asnjë kompani nuk kryen projekte të Komunën falas, andaj duhet të bëhen kontrole rigorozë me rastin e pranimit të punëve. Rregullimi i infrastrukturës së varrezave në shumë rreth 53,000.00€ prej tyre 7,000.00€ nga të hyrat vetanake, po ashtu është mirë të specifikohet se për cilat varreza bëhet fjalë.

Tek Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik kemi një shumë prej 84,000.00€ për të cilën thuhet participim me donatorë në projekte të ndryshme, dhe për këtë dua të ngrisë pyetje, a janë projektet të gatshme apo janë paraparë mjete vetëm sa për të mos u shuar, sepse këso lloj projektesh kemi pasur edhe në KAB 2017 - 2019 por megjithatë nuk kemi pasur ndonjë projekt të vërtetë ashtu për tu përkrahur, nëse ka projekte të gatshme natyrisht se do të përkrahet kjo shumë. Po ashtu është paraparë Funkcionalizimi i zyrës për menaxhimin e projekteve zhvillimore me Partneritet Publiko Privat – PPP dhe me donatorë, shuma 10,000.00€, ne edhe më parë kemi thënë se duhet t'i jepet hapësirë PPP-së respektivisht njerëzve të cilët e kanë një pjesë të mirë të zhvillimit e të cilët do të mund të bartin në Komunën e Podujevës, çështje për të cilën në bazë të bisedave me njerëz të ndryshëm që kemi bërë ne si Grup i LVV-së, na është thënë se qeveria lokale ka neglizhencë në këtë aspekt si dhe po ashtu gjatë takimeve me biznesmen të ndryshëm nga diaspora kemi kuptuar se ata janë të gatshëm të investojnë në Komunën e Podujevës, mirëpo hasin në një neglizhencë të qeverisë lokale. U tha se ka projekte për rrethoja metalike por unë mendoj se është koha të hiqen rrethojat metalike dhe të ketë gjelbërim sepse nuk kemi çka të fshihemi dhe të frikohemi prej askujt sepse jemi qytetarë të këtij vendi, andaj mendoj se nuk duhet të harxhohen mjete buxhetore për këtë çështje, madje janë paraparë 8,000.00€ për hapjen e një pusi në fshatin Orllan ndërsa këshilltarja kolege nga radhët e LVV-së disa herë ka shtruar kërkesë për subvencionim të nënave lehona, dhe nuk është miratuar e që mendoj se është një papërgjegjësi e madhe. Po ashtu është për tu analizuar shuma 435,233.00€ tek Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, e që në parim e përkrahim sepse njerëzit kanë nevojë për investime sidomos në këtë gjendje të rënë ekonomike, por ajo që për ne është e papranueshme është ndarja e subvencioneve, unë edhe më parë e kam thënë se duhet të kemi kritere në bazë të të cilave ndahen subvencionet e Komunës, nuk është problem që përfiton një i LDK-së por vetëm të ketë të përmbushura kriteret dhe vërtetë të jetë në gjendje të rëndë, e jo t'iu jepen njerëzve të cilët punojnë në dy-tre vende apo atyre që jetojnë në qytet dhe fare nuk merren me atë drejtim por vetëm i shfrytëzojnë lidhjet dhe përfitojnë, prandaj në këtë drejtim ndarjes së subvencioneve t'i kushtohet rëndësi më e madhe, dhe sa më shumë ngritje e buxhetit për subvencione aq më mirë është. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, pajisje mjekësore 195,000.00€ nga granti qeveritar, a mund ta dimë për çfarë pajisjesh është fjala, mandej për renovim të objekteve shëndetësore shuma 61,000.00€, për cila objekte shëndetësore bëhet fjalë, duhet të tregohet cili objekt do të rinovohet. Tek Drejtoria e Arsimit, edhe pse në vizionin dhe misionin kemi hasur në kërkesa dhe ankesa të shumta nga kjo Drejtori për mungesë të mjeteve buxhetore, mendoj se tek kjo çështje duhet të kemi

një konsultim më të madh, dhe kur e thash se ka pasur mungesë të transparencës, dua ta ndërlidhi me komisionin e arsimit ku ne në bazë të Rregullores e kemi për detyrë të debatojmë edhe për buxhetin e kësaj Drejtorie, gjë e cila nuk ka ndodhur dhe që do t'i ndihmonte arsimit në përgjithësi, ose kemi rastin e komisionit të Shëndetësisë i cili për katër vite është takuar vetëm një herë dhe kjo është e pa pranueshme sepse mendoj se ato janë gjëra që diskutohen në aspektin profesional dhe aspak në aspektin politik. Në fund kemi edhe Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport ku për ndërtimi i shtëpisë së Kulturës janë paraparë 100,000.00€ dhe pothuajse kjo është bërë si "Ura e Fshejtë" sepse qiten mjete, hiqen mjete, barten etj. dhe çështje tjera të cilat për hir të kohës nuk po mund t'i përmend të gjitha, mirëpo konsideroj se këto gjëra duhet të përfundojnë njëherë e përgjithmonë, dhe ne jemi këshilltarë të Kuvendit me votat e qytetarëve andaj është mirë që projektet – kodet buxhetore vërtetë të jenë serioze, të qëndrueshme dhe të jenë të arsyeshme.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, meqë nuk ka këshilltarë tjerë të lajmëruar për të marrë fjalën, konsideroj se është mirë të marrin fjalën drejtorët e Drejtorive për të dhënë sqarime, arsytetime dhe përgjigje të ndryshme të ngritura nga diskutimet paraprake.

z.Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit (DPUMM), theksoi, unë i evidentova dy çështje që u ngritën nga parafolësit, i përgëzoj të gjithë këshilltarët e Kuvendit për angazhimin e tyre gjatë gjithë kësaj kohe për përgatitjen e projekt buxhetit të Komunës si fazë fillestare. Korniza Afatmesme Buxhetore 2018 – 2020 ka mundësi të korrigohet dhe plotësohet deri në përgatitjen, shqyrtimin dhe miratimin final të projektbuxhetit të Komunës, sepse nga niveli qendrorë të paktën edhe një herë sjellën rekomandimet shtesë. Sa i përket kërkesës së këshilltarit parafolës z.Rafet Llapashtica i cili e potencoi Lagjen Zhitia në fshatin Lluga, ndoshta teknikisht i është përvjedhur ajo sepse ai projekt është paraparë teknikisht për vitin 2018 por është vazhdim dhe me qëllim e kemi shënuar, e tjera lagje, e që me këtë po ndërlidhem edhe me pyetjen e z.Haki Rudarit, sepse ne kemi disa projekte të cilat kanë ardhur prej komuniteteve ku janë cekur, shembull, asfaltimi i rrugës në NN fshatin, që në projekt nuk janë cekur emrat e lagjeve, andaj për atë arsye për ato projekte që kemi menduar i kemi lënë, shembull, Lagja Zhitia, Çunaku etj. në mënyrë që në konsultime me banorët pastaj të emërohet saktësisht. Sa i përket pyetjeve të shtruar nga z.Haki Rudari, ne gjatë përpilimit të listës së projekteve jemi munduar çdo herë, kemi dal në terren, kemi kontaktuar dhe jemi në kontakt me qytetarë pa marrë parasysh cilit subjekt politik i takojnë sepse jemi në shërbim të të gjithë qytetarëve të Komunës së Podujevës, jo vetëm të një elektorati të caktuar. Vërejtjet apo kërkesat që ne i kemi parë si më të arsyeshmet dhe urgjente i kemi përfshirë në këtë listë të projekteve, kurse sa i përket cilësisë së punëve – asfaltit unë nuk jam kompetent sepse janë procedura tjera ato e që edhe ne si Drejtori kemi vërejtje në disa raste, dhe në atë arsyeshmëri të mjeteve kemi bërë kërkesë, kemi kërkuar shqyrtimin e mostrave qoftë prej Operatorëve Ekonomik qoftë prej laboratorëve të caktuara të licencuar nga organet qendrore përkatëse por edhe prej ekipës menagjuese të projekteve përkatëse kapitale. Sa i përket rrugës në gjatësi afër 50 m në Lagjen Kosumi në fshatin Gllamnik, ka qenë angazhim maksimal i joni që të zgjidhet çështja e uzurpimit të pronës, Drejtorja e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë e ka shpallur uzurpator, pronari përkatës ka bërë ankesa në Gjykatë mirëpo tash së fundmi është marrë vendim i formës së prerë dhe ai muri në këtë vit hiqet, procedurat e tenderimit kanë përfunduar pothuajse dhe jemi pran nënshkrimit të kontratës dhe besoj se brenda një kohe shumë të shkurtër ajo pjesë e rrugës do të asfaltohet së bashku me disa rrugë tjera që janë fshatin Gllamnik.

z.Fatmir Gashi, drejtor i Drejtorisë së Administratës (DA), theksoi, u paraqiten vërejtje rreth projektit të paraparë për ndërtimin e rrethojave dhe hapjen e një pusi në fshatin Orllan, përkatësisht në hapësirën përkatëse ku gjenden Ambulanta e Mjekësisë Familjare dhe Zyra e Gjendjes Civile, objekte këto ku mungon elementi kryesorë që është uji, andaj ne kemi paraparë se është shumë e nevojshme të sigurohet uji për ato dy objekte pa dashur të përjashtojmë edhe për raste të tjera, ndërsa sa i përket asaj që parafolësi z.Haki Rudari e tha se ka kaluar koha e rrethojave, do të isha i kënaqur me një gjendje të tillë, por për fat të keq ju them ju dhe z.Rafet Llapashticës se brenda një muaji i kemi të demoluara tri Zyre të Gjendjes Civile, në Kërpimëh, Batllavë dhe Orllan, ndërsa ne e kemi për obligim sigurimin e dokumentacioneve të cilat gjenden në ato Zyre dhe në të gjitha institucionet komunale në përgjithësi, andaj ndoshta ndërtimi i rrethojave në ato objekte nuk është i mjaftueshëm por megjithatë është pozitive.

z.Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit (DSHPMSH), theksoi, sa i përket temës, duke respektuar kohën dhe angazhimin e juaj, ju falënderoj për kritikën, sugjerime apo edhe vërejtjet e dhëna sepse ky dokument – KAB 2018-2020 edhe përkundër shqyrtimit dhe miratimit është dokument i cili i paraprinë projektbuxhetit final dhe si i tillë në një formë mbetet i hapur deri në majin shtator dhe në këtë aspekt mendojmë që nga ju këshilltarë të nderuar por edhe nga meset e ndryshme ende do të marrim propozime dhe kërkesa të ndryshme për projekte kryesisht të investimeve kapitale sepse për shërbimet tjera kemi të bëjmë me angazhimet që ne i bëjmë në vazhdimësi, e që nuk janë të pakta. Meqë buxheti aktual për DSHPMSH na mundëson të kemi rreth 1,200,000.00€ për investime kapitale, me Qarkoren Buxhetore 2018/01 përkatësisht me projektet e propozuara ky buxhet është rritur për rreth 400,000.00€ më shumë. Me seriozitetin më të madh e them se jam përpjekur që t'i reflektoj së pari të gjitha ato projekte që janë vazhdimësi, së dyti në ato rrethe ku investimet viteve të fundit kanë qenë më të pakta dhe ato që janë prioritete si dhe që ne i konsiderojmë që janë më të ngutshme, por sigurisht që ndonjë parti politike ose ndonjë individ i mendon tjera dhe kjo është krejt normale madje edhe po të jetë ndonjë subjekt tjetër në pushtet nuk do të mund të ndryshonte sepse janë projekte të cilat duhet të kryhen në vazhdimësi. Sa i përket çështjes së sqarimeve të projekteve, pajtohem se disa prej tyre duhet të sqarohen dhe të jepen më shumë specifikime, mirëpo konsideroj se me rastin e shqyrtimit dhe miratimit të projektbuxhetit të Komunës dhe projekteve prioritare që do të pason, mund të hymë më në detaje sa i përket sqarimeve të projekteve, për ku dhe si është menduar etj, shembull, tek lumenjtë e kemi një kod të veçantë ku thuhet vazhdimi i zgjerimit të Lumit Llap nga fshati Lluga e këndej dhe lumenjtë tjerë që janë më të vegjël si Dumnica, Kaqandolli, Llapashtica etj. Risi janë disa projekte si, për ujësjellësin në fshatin Orllan jemi duke bërë përpjekje së bashku me KUR-Prishtina dhe me donatorë tjerë të hymë në atë projekt i cili realisht është i kushtueshëm por që është i nevojshëm dhe ne kemi angazhim të madh në këtë projekt, mandej kemi kodin e ri buxhetor për rregullimin e rrugëve të reja me zhavorr, gjë për të cilën kemi shumë kërkesa nga banorët të cilët nuk banojnë në ato zona por që kanë tokë të punueshme, pemëtari edhe kultura tjera bujqësore apo edhe blegtori, rrugë të cilat janë të reja dhe për të cilat ka kërkesa të shumta e që ne patjetër duhet t'iu ndihmojmë, andaj edhe ka hyrë një kod i ri. Për rregullimin e hapësirave publike në qytet është menduar për disa hapësira të cilat kanë të bëjnë më shumë për personat me nevoja të veçanta dhe kryesisht në ato lokacione të cilat herë pas here po ndodh të shndërrohen në deponi të egra të mbeturinave, të cilat synohet të rregullohen. Unë nuk do t'ju marrë kohë më shumë,

por besoj në muajin shtator do të shqyrtohet projektbuxheti i Komunës për vitin 2018 dhe projeksionet për vitet 2019-2020 duke përfshirë edhe propozimet, sugjerimet dhe kërkesat që do të sjellën deri në atë kohë nga ju këshilltarë të nderuar dhe nga qytetarët në përgjithësi.

z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (DBPZHR), theksoi, gjatë planifikimit të projekteve jemi munduar dhe kemi frymuar me mendje, kështu që projektet janë hartuar me mend, zemrën e kemi të madhe mjaftueshëm dhe besoj se pa problem do të vazhdojmë me implementimin e këtyre projekteve të parapara në tri vitet e ardhshme. Me leje të drejtorit të Drejtorisë përkatëse po e jap një sqarim rreth fondit për participim me donatorë, fond ky i cili shfrytëzohet nga të gjitha Drejtoritë e Komunës konkretisht fjala është për projektet të cilat vijnë nga thirrjet për aplikim qoftë nga Komisioni European ose nga ndonjë organizatë tjetër, të cilët kërkojnë që për realizimin e projektit, formë e cila është aplikuar edhe për projektin tani më të përfunduar në fshatin Sfeçël ku prej atij fondi do të thotë janë shpenzuar 63,000.00€. Sa i përket çështjes tjetër që u potencua rreth shtigjeve për ecje dhe për biçikleta, jam në dijeni se ka qenë propozim edhe vitin e kaluar dhe më vie shumë keq që në mungesë të buxhetit nuk është arrit të realizohet një projekt i tillë dhe shpresoj që në vitin e ardhshëm pa problem mund të realizohet sepse është edhe i nevojshëm një projekt i tillë, mirëpo konsideroj se nuk duhet kuptuar Komunën si një Organizatë fitimprurëse ku çdo projekt patjetër duhet të sjellë të hyra, por një projekt i tillë para së gjithash synon që qytetarëve t'iu krijoj mundësi të ecjes dhe relaksimit në ato vende ku janë paraparë përkatësisht te parku i qytetit dhe te pishat në fshatin Kërpimeh, si dhe në të njëjtën kohë në rast se vie ndonjë investitorë ose ndonjë vizitorë dhe pyet se a ka ndonjë vend të caktuar për të ecur lirshëm ose për ndonjë aktivitet sportiv, sigurisht që do të ndihemi komod nëse i drejtojmë në ato vende, pra nuk është ndonjë projekt shumë i kushtueshëm dhe i njëjti ndikon në investime të mëtutjeshme. Sa i përket çështjes së subvencioneve që këshilltari z.Haki Rudari e ngriti, nuk qëndron ajo që u tha sepse është një formular në të cilin përshkruhen saktë kriteret të cilat duhet t'i plotësoj secili përfitues me rastin e aplikimit, ne mendojmë që çështja e subvencioneve nuk bënë të adresohet si çështje sociale për arsye se qëllimi është të ngritët punësimi andaj përfitues mund të jetë edhe ndonjë person i cili i ka kushtet e mira materiale por që për qëllim ka zgjerimin e veprimtarisë bujqësore.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, unë paraprakisht desha ta mbyll temën rreth KAB 2018-2020, mirëpo thjesht për Drejtorinë për Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik ne morëm përgjigje nga drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural edhe pse drejtori përkatës është prezent këtu në sallë, andaj kjo për mua është e paarsyeshme. Drejtori parafolës foli për 3-4 projekte kur kemi parasysh që deri në fund të mandatit kanë mbetur edhe 4-5 muaj, madje foli për disa projekte konkretisht për shtigjet për ecje dhe për biçikleta tek pishat e fshatit Kërpimeh, kurse ai vet si drejtor qe 4 vite nuk ka mund t'i filloj ato projekte, ndërsa të njëjtat i ka përcjellë tek drejtori i z.Ejup Visoka. Pra ne këtu jemi qe afër 4 vite, drejtori z.Avni Fetahu është ekonomist me profesion, por edhe në qoftë se një person është bujk me profesion, madje edhe me shkollë të mesme, do ta mund ta shihte dhe ta prekte investimin. Mendoj se Drejtori i Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik nuk e ka të ndaluar të del në foltore të na tregoj se si bëhet zhvillimi i Komunës, si zhduket papunësia, si zhduket varfëria, e them këtë sepse po të ishte ashtu siç e potencoi drejtori parafolës, atëherë do të ishte vetëm një Drejtori dhe Kryetari i Komunës, mirëpo ligji ka ndarë profilet përkatëse si Drejtoritë (për bujqësi, infrastrukturë, zhvillim ekonomik,

inspeksion, kadastër etj.) dhe secili në fushën e tij ka opsionet e veta se si do ta udhëheqë dhe çka do të ndryshoj ndër vite, dhe në këtë kontekst unë në këtë përfundim të mandatit shumë pak jam i interesuar të dëgjoj për ndërtimin e shtigjeve në parkun e fshatit Kërpimëh apo atë në qendër të qytetit. Prandaj mua më intereson të dijë se sa ka mendje një zyrtar i Komunës i cili udhëheqë një Drejtori ta ndryshoj prej viti në vit Komunën e Podujevës për 4 vite mandat, kushdo qoftë ai drejtor dhe pa marrë parasysh cilit subjekt politik i takon, këtë e ndërlidhi edhe me sjelljen e planifikimit të projektit për ndërtimin e shtigjeve në fjalë në vitin 2018 apo 2021, gjë e cila është shumë e pa kuptimtë. Nuk dëshiroj të gjykoj drejtorin parafolës por as nuk dëshiroj t'ia jap të drejtën për të marr fjalën për çështje të cilat i takojnë një drejtori tjetër i cili është prezent këtu në sallë z.Ejup Visoka të cilin e respektoj dhe për të cilin jam në dijeni se kusht është, çfarë postesh ka mbajtur në të kaluarën, jam në dijeni sa dinë dhe mendoj se në këtë fushë mund të përgjigjet më mirë se drejtori parafolës z.Avni Fetahu. Duke mos dashur të ngriti dilema, të mos thuhet se këto janë projekte të cilat sjellën në Kuvend, miratohen e pastaj shfrytëzohen nga të gjitha Drejtoritë, ndërsa pastaj ndryshohen, nëse Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik ose secila Drejtori tjetër apo edhe Kryetari i Komunës që nga viti 2013 deri në vitin 2017 nuk ka mund ta zhdukë mirëqenien sociale ose papunësinë 0.5% në Komunën e Podujevës, atëherë ne pajtojmë me këtë KAB 2018 – 2020 dhe e kalojmë me vota qoftë tani qoftë edhe në muajin shtator si projektbuxhet, ne jemi këtu, mund edhe të mos e miratojmë dhe nuk ka kurrfarë problemi, por problemi është se ti çka po thua si drejtor *(i drejtohet z.Avni Fetahu)*.

z.Naim Çunaku, theksoi, para vetës kemi Kornizën Afatmesme Buxhetore 2018 – 2020 si një dokument i cili është vetëm fillim ose hap i parë i përgatitjes së projektbuxhetit të Komunës për vitin 2018 dhe prioriteteve për vitet 2019-2020. Nga ajo që u dëgjua këtu, më bëri përshtypje që pati shumë vërejtje në disa segmente të caktuara, mirëpo nuk dëgjova nga askush prej nesh si këshilltarë të Kuvendit që pati ndonjë iniciativë apo ndonjë propozim projekt kur kemi parasysh se për derisa jemi në këtë fazë të përgatitjes së projektbuxhetit, është shumë e arsyeshme dhe shumë lehtë do të mund ta inkorporonim si një projekt të qëlluar të ndokujt. Pra askujt nga ne nuk i është cunguar e drejta që nëse kemi ndonjë vizion apo një propozim projekt të caktuar ta propozojmë dhe ta bëjmë pjesë të KAB 2018 - 2020.

U fol shumë për Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, drejtori të cilën me rastin e themelimit të saj në këtë Kuvend para disa viteve gjegjësisht kur kemi bërë plotësim ndryshimin e Statutit të Komunës, synim, vizion dhe qëllim ka qenë që kjo Drejtori të jetë një adresë për të gjithë të interesuarit, gjegjësisht ata të cilët mund të participojnë ose të hulumtojnë donatorë të ndryshëm të cilët mund ta kontaktonin drejtpërsëdrejti një Drejtori e cila pastaj të mund të hap bashkëpunimin dhe të ketë një bazë solide, edhe pse çfarë baze ekonomike ka pas dihet, mirëpo krejt qëllimi ka qenë që të kemi një adresë për zhvillim ekonomik. Po ashtu u përmend edhe projekti për inkubator të biznesit dhe nuk di si është kuptuar kjo dhe nëse e marrim këtë për nga terminologjia, nga fusha e biologjisë apo mjekësisë etj, fjala inkubator dihet çka është, mirëpo nëse e marrim për nga lëmia e ekonomisë, inkubator do të thotë koncentrim i zhvillimit të bizneseve në një lokacion të caktuar, dhe kur jemi në dijeni se Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, Komuna në përgjithësi apo shteti si tërësi nuk mund të bënë biznese, por cakton lokacione dhe ndërton infrastrukturë, ky projekt, edhe pse ndoshta me një buxhet të vogël, është i pranueshëm, i mirëseardhur, pse jo edhe me vizion sepse bizneseve të cilat ushtrojnë aktivitetet e tyre në Komunën e Podujevës, t'ju ofrojmë lokacion të caktuar në të cilin pastaj

mund të ushtrojnë veprimtaritë e tyre biznesore më lirshëm dhe si adresë e bizneseve më e vure në pah do ta thojë. Sa i përket projekteve për ndërtimin e shtigjeve për ecje dhe për biçikleta, mos të harrojmë se për zhvillimin ekonomik të Komunës së Podujevës nuk kemi kush e di çfarë potencialesh, madje shumë herë me rastin e shqyrtimit dhe miratimit e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal, kemi menduar se potencialet e fjetura të Komunës tonë në veçanti janë në fushën e turizmit, dhe nëse ne i shfaqim ato me pak investime sa kemi mundësi përkatësisht nëse nuk shihet dora e Komunës si institucion që të paktën të ndërtohet një infrastrukturë me ato shëtitore në ato vende, nuk di si t'ia paraqesim ndokujt pastaj si atraksion turistik në mënyrë që të tërheqim vizitorë, e që në botën e tanishme tërheqja e vizitorëve dhe turizmi është një prej ekonomive më të forta, andaj edhe në Komunën tonë është njëra ndër vlerat më të forta që kemi do të thojë. Pastaj pati adresime në drejtim të Drejtorisë së Administratës e që për mendimin tim u ngatërruan kompetencat me atë të Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik. Unë një ditë më parë në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa i kam paraqitur dy vërejtje mirëpo në të njëjtën kohë i kam dhënë edhe alternativat se si mund të bëhen, andaj edhe kam gjetur përkrahjen që të njëjtat të jenë pjesë e KAB 2018 – 2020. Për fund do t'ju kisha lutur të gjithë atyre që kanë propozim projekte konkrete me të cilat mund të pasurohet kjo Kornizë Afatmesme Buxhetore, t'i paraqesin ato dhe të përkrahen nga të gjithë ne, dhe kjo Kornizë të jetë dokument i zhvillimit ekonomik të Komunës së Podujevës, pavarësisht a me zemër, a me shkronja, sepse edhe nëse nuk jemi në këtë pozicione që jemi fundja jemi qytetarët të Komunës së Podujevës dhe të mirat do t'i prekim bashkërisht por edhe fëmijët tanë.

z.Fidan Rekalii, përshëndeti të gjithë të pranishmit në sallë, theksoi, ndoshta paksa jashtë temës, mirëpo konsideroj se për herë të fundit do të jem këshilltar i Kuvendit të Komunës së Podujevës, pozitë të cilën pas dy mandateve po e përfundoj. Konsideroj që sadopak e kam dhënë një kontribut për Komunën e Podujevës dhe besoj që edhe në pozitën e re do ta bëjë një gjë të tillë. T'ju them të drejtën jam paksa i emocionuar sepse pikërisht këtu në këtë Kuvend ka filluar për herë të parë karriera ime si 22 vjeçar që isha dhe këshilltari më i ri në moshë, ndërsa tani po e lë punën si këshilltar i Kuvendit të Komunës së Podujevës. Singerisht e them se kam qenë shumë i nderuar t'i përfaqësoj interesat e qytetarët e Komunës së Podujevës. Dëshiroj t'i falënderoj shefat e Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit, dhe të gjithë këshilltarët e Kuvendit për një bashkëpunim të mirë, demokratik dhe korrekt që kemi pas gjatë këtij mandati. Sipas rezultateve përfundimtare të publikuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, unë do të jem deputet i legjislaturës së ardhshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, dhe nga ai pozicion që do të jem ju premtoj dhe ju ftoj të gjithëve për bashkëpunim në interes të qytetarëve të Komunës së Podujevës në veçanti, dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës në përgjithësi. Unë për dy vite e gjysmë kam qenë këshilltar i Ministrit të Ministrisë së Infrastrukturës z.Lufti Zharku, dhe nga ajo pozitë asnjëherë askënd nuk e kam shikuar për nga përkatësia politike, por me të gjithë kam bashkëpunuar pa interferime politike dhe me fokus në interes të qytetarëve të Komunës së Podujevës, mirëpo edhe sot këtu ju premtoj se do të jem zëri i të gjithë qytetarëve të Komunës së Podujevës, këtë e them edhe duke pasur parasysh se jam i vetmi kandidat – llapjan i cili kam arritur votat e mjaftueshme për deputet, nga të gjithë kandidatët tjerë të propozuar nga të gjitha subjektet politike, dhe këtë e marrë si përgjegjësi shtesë. Edhe njëherë ju falënderoj të gjithëve për bashkëpunim.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, në emër të Kuvendit të Komunës së Podujevës falënderoj z.Fidan Rekaliun për angazhimin dhe kontributin e dhënë gjatë këtyre viteve në Kuvendin e Komunës së Podujevës dhe njëkohësisht i dëshiroj shëndet dhe suksese në punë të mëtutjeshme në pozitën e re si Deputet i Kuvendit të Kosovës.

z.Haki Rudari, theksoi, fillimisht në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e LVV-së dhe në emër timin personal e uroj kolegun z.Fidan Rekaliu për pozitën e re si deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe njëkohësisht ia rikujtoj atij se edhe znj.Saranda Bogujevci nga Podujeva ka arritur numrin e mjaftueshëm për deputete.

Sa i përket temës për të cilin jemi duke diskutuar u dhanë disa arsytetime nga ana e drejtorëve, po filloj me Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe i them drejtorit se në atë pjesë për të cilën ai foli gjendje e rëndë ka qenë që dhjetë vite thuajse dhe ka qenë uzurpim i asaj prone, andaj është dashur të ndërmerren masa shumë më herët. Po ashtu u përmenden subvencionet, natyrisht se ne jemi për subvencione por sinqerisht për subvencione të cilat ndahen në bazë të kriterëve dhe për ata të cilët vërtetë e meritojnë të marrin subvencione, unë njoh njerëz të cilët kanë qenë përfitues të subvencioneve dhe të njëjtit kanë dy apo tre anëtar të familjes të punësuar. Sa i përket Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpërthimit, po e përmendi vetëm pikën 12 të dokumentit përkatës ku thuhet rregullimi i varrezave, shuma e paraparë 53,000.00€, a mund ta dijmë se për cilat varreza bëhet fjalë, sepse gjendja e varrezave në përgjithësi dhe e përmendoreve është jo e mirë, shembull, në fshatin prej nga vij unë është duke u bërë rregullimi i tyre me donatorë të ndryshëm dhe në participim të komunitetit.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, fillimisht urime z.Fidan Rekaliu për pozitën e re dhe njëkohësisht të falënderoj për bashkëpunimin politik që kemi pasur gjatë këtij mandati në Kuvendin e Komunës.

Nuk dëshiroj të bëjë replikë me askënd mirëpo në një formë u detyrova të marrë fjalën për arsye se edhe z.Naim Çunaku paraprakisht mori fjalën dhe në vend që ai të shtronte pyetje drejtorit, ai dha përgjigje në vend të drejtorit lidhur me pyetjet që unë i parashtrova. Besoj se shumë kuartë e kuptoj fushëveprimin e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, po ashtu e kuptoj kuartë konfiguracionin e zhvillimit të turizmit në Komunën e Podujevës duke përfshirë edhe propozimet për zhvillimin e Komunës së Podujevës. Nëse Grupi nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës e ndryshon propozim vendimin përkatës atëherë ne si Grup nga radhët e PDK-së i japim propozimet tona për ndryshim të mjeteve dhe kodeve buxhetore për Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, përndryshe ne nuk kemi çfarë të propozojmë sepse ky është vendim i cili merret në mënyrë demokratike dhe njerëzore për të bërë apo jo diçka, mirëpo turizëm me shteg për biçikleta nuk mund të bëhet, projekt i cili ka mundur ndoshta të sjellët nga një fushë tjetër por jo nga DPZHE.

z.Durim Salihu, drejtor i DPUMM, theksoi, z.Haki Rudari e ngriti çështjen rreth një pjese në një rrugë në fshatin Gllamnik gjë për të cilën unë isha shumë i qartë në sqarimin e mëparshme që e bëra dhe sërish e përsërisë se ai problem është tejkaluar dhe shumë shpejtë do të asfaltohet edhe pjesa e mbetur. Gjithashtu u përmend edhe rregullimi i Bulevardit dhe sheshit në qytet në vitin 2018, unë edhe në mbledhjen e kaluar i kam dhënë, arsytet pse është rialokuar shuma prej 930,000.00€, ndërsa sa i përket shtatoreve të Heronjve, ajo e Heroit Ali Ajeti është në procedurë të vlerësimit të ofertave, kurse shtatorja e Heronjve Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu, Ilir Konushevc, Edmond Hoxha është në fazën finale ku tani veç kemi pranuar formën e bazamentit për t'i vendosur dhe ato do të vendosen në një periudhë shumë të shkurt, kështu që për vitin e ardhshëm është menduar që të filloj

infrastruktura nëntokësore për krijimin e hapësirës prej 28 mijë m² që i përfshinë edhe bazamentin përreth këtyre dy shtatoreve në fjalë.

z.Bahri Selimi, theksoi, meqë iu dha shumë jehonë këtij buxheti të shpërndarë në këtë Kornizë Afatmesme Buxhetore 2018 – 2020, unë një formë u detyrova të marr fjalën dhe atë kryesisht rreth investimeve kapitale, kategori për të cilën është rritur buxheti për tri vitet e ardhshme dhe kjo më ka bërë të ndihem mirë sepse kjo është në interes të qytetarëve dhe që ka ndikim të drejtpërdrejtë tek qytetarët e Komunës së Podujevës, mirëpo ajo që nuk më ka bërë përshtypje është mos rritja e të hyrave vetanake ku sipas këtij dokumenti pothuajse është shumë e njëjtë e parashikuar për tri vitet e ardhshme pa pasur rritje në këtë aspekt, çështje për të cilën mendoj se mungon një menaxhim më i mirë i pronave komunale. Gjithashtu u fol shumë për këtë KAB 2018 – 2020 kryesisht për Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, dhe për Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, realisht mendoj se pjesa më e madhe e buxhetit të Komunës për tri vitet e ardhshme është e ndarë për këto dy Drejtori, në të cilat nga rreth 6,500,000.00€ sa janë të parapara për vitin 2018, 3,120,199.00€ apo 47% e buxhetit për investime kapitale janë për DPUMM, kurse rreth 2,170,000.00€ apo 33% janë të ndara për DSHPMSH e që në total i bie që këto dy Drejtori të kenë rreth 80% të buxhetit për investime kapitale përdërisa për vitin 2018 për Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale janë të ndara 6.15% ndërsa në Drejtorinë e Arsimit 6.64%, shuma dhe përqindje të cilat besoj se do të vazhdojnë njëjtë pothuajse edhe në vitet 2019 – 2020 me theks të veçantë në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, dhe në Drejtorinë e Arsimit, gjendje e cila na bënë të nënkuptojmë dhe ta themi qartë, si mund të kemi zhvillim ekonomik të mirë përdërisa në arsim kemi vetëm rreth 6.64% të buxhetit të ndarë apo si mund të kemi shëndetësi të mirë kur kemi vetëm 6.15% të buxhetit të ndarë, kurse për gjendjen në arsim jemi në dijeni të gjithë sepse e kemi potencuar shumë herë se në përgjithësi është në gjendje të keqe dhe tani sërish ndahen vetëm 6.64% e buxhetit të cilat vazhdimisht ndahen vetëm për renovimin dhe zgjerimin e objekteve shkollore, realisht unë nuk jam kundër infrastrukturës rrugore, asfaltimit të rrugëve, rregullimit të kanalizimeve etj, mirëpo gjithëherë të ndahet një buxhet dhe përqindje e tillë për arsim, njëmend nuk di se si do të arrijmë suksese në arsim dhe ku do t'i shkollojmë fëmijët tanë në të ardhmen, andaj në këtë aspekt ju sugjeroj që këtyre dy Drejtorive t'i kushtohet kujdes më i madh në dokumentet buxhetore të radhës në mënyrë që me rastin e miratimit final të projektbuxhetit të Komunës në muajin shtator këto dy Drejtori të kenë një buxhet shumë më të madh sepse vërtetë qëndrojmë keq në këto dy fusha.

Sa i përket shpërndarjes së buxhetit nëpër fshatra apo thënë ndryshe përfshirja e fshatrave në buxhet, njëmend del se shumë pak fshatra përfshihen në investime nga buxheti i Komunës, gjë të cilën e kam thënë edhe më parë, shembull, në vitin 2018 në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit janë përfshirë vetëm 28 fshatra nga 78 sa janë gjithsej, pastaj në Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit vetëm 20 fshatra dhe njësoj vazhdojnë planifikimet edhe për vitet e ardhshme, mandej ka fshatra të cilat për mendimin tim janë të privileguara e që këtë fenomen duhet ta largojmë prej shpërndarjes së buxhetit në mënyrë që në të ardhmen shpërndarja e buxhetit nëpër fshatra të bëhet proporcionalisht në bazë të numrit të banorëve të fshatrave përkatëse, e them këtë edhe duke u bazuar se ka fshatra që në tri vitet e ardhshme nuk janë paraparë investime fare, kurse ka fshatra të cilat janë përfshirë investime madje ndoshta dy-tri herë brenda një viti varësisht prej projekteve të ndryshme.

znj. Adelinë Stublla, theksoi, dua të ndalem në disa projekte të përshkruara në këtë dokument, sikurse që është, asfaltimi i rrugëve, pa u cekur se për ku bëhet fjalë, pastaj siç u përmend edhe nga disa parafolës kemi përshkrimin e projektit, rregullimi i trotuareve, rregullimi i urave. Tek projekti për rregullimin e trotuareve do të ndalesha tek shkolla “Xheladin Rekaliu” ku trotualet mungojnë dhe nxënësit duhet të ecin në rrugë për shkuar në shkollë gjë e cila e rrezikon jetën e tyre, pastaj kemi planifikime për ndriçimin publik të fshatrave e që mendoj se mirë që po punohet në këtë drejtim, mirëpo në qendër dhe në lagje të qytetit mungon ndriçimi siç është rasti i Lagjes Babatinca dhe Tovërlani ku në mungesë të ndriçimit mund të rrezikohet edhe jeta e ndonjë banori pasi që në ato Lagje mungojnë edhe trotuari dhe rrethojat mbrojtëse afër lumit Llap. Sa i përket ndërtimit dhe shtimit të parqeve të qytetit, pyetje, në cilat vende do të shtohen parqet dhe në cilat vende do të ndërtohen apo zgjerohen këto parqe, ndërsa sa i përket parqeve dhe vendeve të gjelbëruara pyes, përse nuk investohet në rregullimin, mirëmbajtjen dhe ndriçimin e pjesës mbraza kafiterive – afër Çerdhes publike, vend i cili nuk ngjason si vend relaksimi por vetëm si vend frike dhe trishtimi sidomos natën. Pastaj kemi projektin e paraparë për ndërtimi i objektit të ri të emergjencës, andaj dëshirojmë të njoftohemi se në cilin vend do të ndërtohet ai objekt pasi që premtimi i Kryetarit të Komunës gjatë fushatës zgjedhore ka qenë se emergjenca do të ndërtohet tek ish objekti i autoshkollës në afërsi të hotel “Besiana” . Pastaj kemi projektin e paraparë për vendosjen e rrethojave dhe grilave për zyrën e vendit në fshatin Lluzhan në shumë rreth 6,000.00€ e që mendoj se është shpenzim së koti ngase tani në këtë kohë nuk duhet të vendosen gjëra të tilla, madje kemi rastin e Shpend Ahmetit i cili i ka hequr pothuajse të gjitha grilat në Prishtinë dhe në ato vende ka bërë gjelbërim. Sa i përket ndërtimit të fushave të hapura, jemi të interesuar të dimë se në cilin vend është planifikuar të ndërtohen ato. Për fund edhe një pyetje, a do të filloni në këta muaj sa ju kanë mbetur qeverisje, a do të hapni ndonjë gurë themel për ndërtimin e një çerdheje në fshatin Lluzhan gjë që është shumë e nevojshme për atë pjesë sepse ka banorë të interesuar dhe sa jam në dijeni është edhe kërkesë e tyre, si dhe çka do të bëhet me objektin e strehimores për fëmijët jetim në fshatin Orllan, pasi që për të njëjtin nuk është cekur fare në këtë dokument, dhe a do të filloj puna e maternitetit apo do të mbetet vetëm si suvenirë.

z.Faik Muçiqi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, dëshiroj të jap disa sqarime kryesisht këshilltarëve të LVV-së. Unë në fillim e sqarova se për të gjitha projektet të cilat janë të përgjithshme me kënaqësi do t'i përmendi – me listë në muajin shtator me rastin e shqyrtimit dhe miratimit të projektbuxhetit të propozuar, madje nëse dëshironi unë i përfshijë edhe në dokumentin përkatës të gjitha lokacionet në të cilat do të investohen edhe pse ndoshta është listë e gjatë ajo dhe vetëm mund të kemi ngarkim të dokumentit ku vetëm brenda DSHPMSH janë afërsisht 80 lokacione. Absolutisht nuk është e vërtetë ajo që u tha se në kuadër të DSHPMSH për vitin 2018 është paraparë të investohet vetëm në 20 lokacione, mirëpo ashtu sikur se që është punuar në të gjitha lokacionet, sikur se që është duke u punuar në këtë vit që jemi, ashtu do të punohet në të gjitha lokacionet dhe këtë do t'jua dëshmoj edhe me raporte, por jo të thuhet se vetëm 20 fshatra janë përfshirë për të investuar nga ana e Drejtorisë në fjalë.

Unë deri në një masë e kuptoj z.Bahri Selimin, mirëpo kemi të bëjmë me ndryshimin e strukturës së investimeve kapitale dhe shërbimeve, që Ministria përkatëse i paraqet në kornizat e saj. Unë me gjithë qejf do të propozoja më shumë projekte për investime kapitale nga shërbimet, subvencionet etj të ngjashme, mirëpo kemi kufijtë e përcaktuar paraprakisht që nuk na lejojnë një gjë të tillë, sepse tani brenda strukturës së investimeve kapitale ndodh

që dy Drejtori të kenë më shumë buxhet dhe hapësirë ose projektet janë të atilla, ndërsa në ndërkohë mund të ketë ndonjë projekt i cili mund të lëviz nga një Drejtori në një Drejtori tjetër. Pra ne kemi përgatitur dhe propozuar këto projekte, sigurisht që kërkesat kanë qenë më të mëdha por këto na janë pranuar, dhe në këtë aspekt besoj që secila Drejtori ende ka nevojë për investime kapitale shumë më shumë. Sa i përket ndriçimit publik, në këtë vit janë së paku 25 rrugë dhe rrugica brenda qytetit në të cilat do të investohet dhe ato do t'i paraqes saktë me rastin e raportit, por nuk do të ndalem sot sepse nuk jemi duke diskutuar sot për suksese ose mos suksese, por jemi duke diskutuar për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2018 – 2020, andaj nuk e shoh të rrugës të përmendi sot në detaje se ku është punuar ose ku nuk është punuar, por një gjë të tillë do ta bëjë në muajin shtator kur para vetës do të kemi propozim projektbuxhetin final i cili do të shqyrtohet në detaje, dhe atëherë do të shihni se nuk qëndrojnë vërejtjet e dhëna siç ishte ajo që do të investohet vetëm në 20 fshatra, e që për mua është e paqëndrueshme.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka këshilltarë tjerë të lajmëruar për të marrë fjalën, unë po e përfundoj këtë pikë të rendit të ditës me disa konstatime.

KAB e Komunës së Podujevës për vitin 2018 dhe planifikimet për 2019-2020 është një proces, sigurisht jeni në dijeni se janë mbajtur edhe debate publike buxhetore, pastaj është diskutuar në mbledhjen e KPF-së nga e cila kanë rrjedhë edhe dy rekomandime, gjithashtu është diskutuar edhe sot gjatë kësaj mbledhje por që nuk kemi pasur propozime konkrete, mirëpo meqë afati ligjor për miratimin e projektbuxhetit të Komunës është 30 shtatori, unë lus drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave që shqyrtimi në Kuvend të bëhet para fillimit të fushatës zgjedhore që fillon më 21.09.2017. Të gjitha vërejtjet dhe propozimet që mendoni se janë projekte të rëndësishme, është mundësia t'i propozoni dhe është në interes tonin që ato të cilat janë me vend të inkorporohen dhe miratohen si të tilla, kurse me rastin e miratimit në Kuvend ai vendim shkon në Ministrinë përkatëse, vlerësohet dhe pastaj është përgjegjësi e Ekzekutivit të Komunës ta zbatoj vendimin e Kuvendit. Pati edhe disa çështje tjera të cilat mendoj se ishin më shumë politike, por që nuk dëshiroj të ndalem, andaj e hedh në votim Kornizën Afatmesme Buxhetore 2018 – 2020 të Komunës së Podujevës.

Pas votimit u konstatua se me 19 vota për, 1 votë kundër dhe 14 vota të përmbajtura u miratua Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) 2018 – 2020 e Komunës së Podujevës.

4. Propozim vendimi për miratimin e përbërjeve të Komiteteve Konsultative.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, fjalën e ka z.Faik Muçiqi drejtor i SHPMSH, të na jap sqarimet për punën e Komisionit, pasi që ka qenë edhe kryetar i Komisionit intervistues përkatësisht Panelit përzgjedhës .

z.Faik Muçiqi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, fillimisht falënderoj të gjithë anëtarët e Komisionit për punën e kryer. Kemi bërë intervistimin e të gjithë konkurruesve dhe jemi munduar që propozimet e bëra Kuvendit të jenë më të drejtat, më korrektet. Singërisht nuk kemi pasur asnjë interferim. Gjatë procesit të vlerësimit dhe votimit kemi qenë shumë afër njëri tjetrit, kemi qenë bukur shumë korrekt. Kandidatët për Komitetin e Zhvillimit Ekonomik kanë qenë shumë më të përgatitur të cilët kryesisht kanë qenë me fakultet ekonomik, se sa kandidatët tjerë për komitetin tjetër. I kemi propozuar këta kandidat, janë të rinjë dhe me

përgatitje profesionale, që presim se do t'i kontribuojnë Drejtorive përkatëse dhe kërkoj nga ju që t'i miratoni.

z.Bahri Selimi, theksoi, më vjen mirë që më në fund po i shoh dy Komitete të tilla të formuara, mirëpo njëkohësisht më vjen keq kur e paramendoj formën e këtij Komisioni përzgjedhës se si është formuar, ka qenë një komision komplet i karakterit politik, në të cilin nuk janë përfshirë të gjitha subjektet politike të Kuvendit. Mendoj dhe jam shumë i sigurt se gjatë përzgjedhjes komisioni është dashtë të paktën të jetë nga të gjitha subjektet e përfaqësuar në Kuvend, pikërisht për të eliminuar politizimin, atëherë pak më bën me dyshuar që edhe këto dy komitete nuk janë komplet politike.

z.Hasan Softolli, theksoi, kam qenë anëtarë i atij Komisioni dhe mund të them se nuk ka pas kurrfarë animesh politike. Kemi bërë intervista shumë të mira dhe mund të them se shumica e kandidatëve kanë qenë shumë të mirë, kështu që përzgjedhja s'ka pas kurrfarë karakteri politik. Komisioni ka funksionuar në mënyrën më të mirë të mundshme.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, nuk ka qenë dashur të ngritët debat rreth temës për arsye se komisionet faktikisht janë politike sepse përfaqësojnë subjektet politike, por kemi edhe komisione kur nuk janë të përfaqësuar të gjitha grupimet politike dhe këtu duhet të kemi besimin reciprok, fjala vjen aty ku nuk është e përfaqësuar PDK, por kur jep vlerësim LVV unë i besoj dhe duhet të besojmë. Nëse nuk i besojmë askujt atëherë më nuk mund të merremi me këtë punë. Unë mbaj qëndrim parimor dhe e kritikoj edhe përfaqësuesin e subjektit PDK nëse eventualisht nuk e kryen punën si duhet. Kryetar i Komisionit ka qenë drejtori z.Faik Muçiqi që i takon subjektit politik LDK. Si anëtar i Komisioni nuk jam në dijeni se ka pas ndonjë ankesë në Komision, si procedurë. Po të kishte ndonjë ankesë nga konkurrentët se te anëtarët e Komisionit kanë vërejtur ndonjë tendencë politizuese është dashur të vjen në Kuvend, dhe për këtë kam pyetur të gjithë anëtarët e Komisionit, por s'ka pasur, sepse në të kundërtën unë do të kërkoja që ky vendim të sjellët fare sot në Kuvend. Sa i përket konkurrentëve, i tregoj z.Bahri Selimit sepse jemi të një profili dhe e kemi të njëjtën përgatitje, jemi munduar të bëjmë përzgjedhjen më të mirë prej konkurrentëve. Këtë e them për hir të konkurrentëve që nuk kanë arritur të përzgjedhën, por jo për shkak të kërkesës së LVV-së. Si anëtar i Komisionit po ashtu po i drejtohem përfaqësuesit të "Radio Llapit" i cili po bënë incizimin medial të mbledhjes dhe nga i njëjti kërkoj që diskutimi të incizohet në tërësi, që ta dëgjojnë edhe të tjerët, e jo herë të lëshohet e herë të ndalet dikujt po dikujt jo, por duhet të jemi transparent të gjithë. Unë po flas në mënyrë shumë demokratike sepse kemi përgjegjësi politike, por jo, ta zëmë, nëse kanë ardhur persona në zyrat e PDK-së dhe janë ankuar, tani të thuhet se këta të subjekteve tjera janë "kriminel" në njëfarë forme, unë nuk e bëjë një gjë të tillë. Unë po them në mënyrë njerëzore për ata që nuk kanë kaluar, ka pas konkurrentë, se është mirë kur ata ankohen diku në zyrat politike, ose në mënyrë njerëzore po them se në përbërje të Panelit kemi qenë 5 anëtarë në përbërje të të cilit ka qenë edhe një vajzë e shoqërisë civile, dhe nëse nuk qëndron kjo që po e them në vazhdim, mund të më kundërshtojnë, ka pas një kandidate e cila asnjë fjalë para Komisioni nuk ka qenë në gjendje ta thotë. Pra desha të jap sqarime se Komisioni ka qenë politik sepse jemi anëtarë politik. Kemi komitete kur nuk jemi të përfaqësuar ne si Grup i PDK-së, ne i japim vërejtje tona, por kur ato argumentohen ne edhe i besojmë, shembull kemi një anëtarë i cili ka qenë nga radhët e PDK-së por i cili nuk është më, por të njëjtit i besojmë kur jepen arsyetime dhe sqarime rreth dhënies së pronave në shfrytëzim, ashtu siç i besoj z.Bahri Selimit kur ai arsyeton dhe sqaron dhënien e pronave në shfrytëzim. Nuk kisha dashtë të dal dhe të arsyetohem para teje (*i drejtohet Bahri Selimit*)

sepse arsyetohem vetëm para punës dhe ligjit dhe rregulloreve me të cilat themelohet komisioni, dhe punës së kryer nga ana e tij, por këtë e bëjë për hir të transparencës. Ka pas rast ku unë kam qenë i propozuar për një komitet por që për shkak të gjithëpërfshirjes kam heq dorë dhe ka shkuar znj. Adelinë Stublla nga LVV-ja edhe përkundër asaj që ne sa i përket numrave ne jemi më lartë, andaj unë i kuptoj shumë mirë lojërat dhe lëvizjet politike, por dikujt duhet t'i besohet. Ndoshta e zgjata paksa këtë diskutim por krejt këtë e bëra për hir të transparencës. Për fund kushdo që ka ndonjë ankesë, edhe ata konkurrent që janë ankuar në zyrën e LVV, ju si subjekt ngritni një komision dhe intervistoni në këto fusha dhe të shohim se çfarë po ju përgjigjen, pastaj sillni në Kuvend propozimet e juaja politike.

z.Naim Çunaku, theksoi, fillimisht i përgëzoj kandidatët e përzgjedhur dhe e përgëzoj Kuvendin që më në fund ka arritur të përmbyll një obligim ligjor dhe i kërkuar sidomos prej OSBE-së. Ky Kuvend e ka themeluar një Panel përzgjedhës i cili ka marrë besimin e anëtarëve të Kuvendit dhe i njëjti para kuvendit ka sjellë një propozim për të cilin ne si Kuvendi i kemi dhënë autorizime t'i shqyrtojnë. Unë e përkrah dhe absolutisht nuk ka asnjë element pse të dyshoj. Më bëri të dal në foltore, ajo që ka të bëjë me përfaqësimin e grupeve të këshilltarëve nëpër komisione të caktuara. Jemi në fund të mandatit dhe besoj që shumë nga ne nëse nuk e kanë ditur në fillim të paktën në fund të mandatit janë në dijeni që edhe Kuvendi ka një Rregullore dhe Statut të Komunës dhe Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe funksionon bazuar në këto akte. U përmend se një subjekt politik ka pas ose s'ka pas përfaqësues në komisione të caktuara. Duhet të lirohemi nga logjika ku nuk jam unë aty është keq. Në Komisionin për shqyrtimin e ankesave për dhënien e pronave të Komunës në shfrytëzim në këtë Kuvend, po të merrej parasysh fuqia politike e grupeve, sigurisht që do të kishte përfaqësues PDK, e jo LVV, por vullneti i Kuvendit ka qenë dhe ka përkrahë përfaqësuesin e LVV-së dhe nuk e ka përkrah përfaqësuesin e PDK-së. Të njëjtin rast e kemi tani këtu. Askush nuk ja ndalon asnjë anëtar të Kuvendit nëse ka diçka personale për ndonjë nga anëtarët e komisionit, që të vihet në rend dite dhe të shkarkohet. Unë i uroj ata që janë përzgjedhur, ndërsa sugjeroj të liroheni prej logjikës se, ku nuk jam unë është keq, sepse edhe pa qenë unë bëhet mirë.

z.Bahri Selimi, theksoi, nëse unë e ngrita këtë çështje, më konkretisht se komisionet janë politike, unë kam emra të këtyre kandidatëve dhe e di edhe cilave subjekte politike i përkasin. Bindjet politike sot po zbulohen shumë lehtë, sidomos përmes rrjeteve sociale dhe nuk e thash rastësisht se janë komitete politike. Te çështja e përfaqësimit që u përmend aq shumë, përfaqësimi në fillim sa jam në dijeni ka qenë shumë real dhe unë nëse i përkas ndonjë komisioni dhe këta kolegët e mijë që janë në atë komision që u përmend shumë herë e dinë që jam shumë autokritik edhe ndaj vetë atij Komisioni, se nuk mund të pajtoj me të gjitha çështjet. Dhe nëse dikush po e kritikon një komision tjetër të formuar politikisht dhe në një farë forme jo të votuar nga të gjithë anëtarët e Kuvendit, sepse ka raste që kanë dalë nga salla dhe nuk e kanë pritur as votimin, megjithatë është miratuar, e ngrita tezën jo te Komisioni por te formimi i këtyre komiteteve. këto Komitete janë formuar në mënyrën ashtu si ma merr mendja, nëse ju keni më shumë argumente për të kundër argumentuar këtë çështje atëherë bëjeni, ngase unë po mendoj ashtu sepse kam emra konkret që e di se i përkasin subjekteve politike dhe goxha militant. Këtu është krejt qëllimi.

z.Haki Rudari, theksoi, parafolësi, koleg i imi nga radhët e Grupit LVV i ngriti disa çështje të cilat për hir të korrektësisë duhet sqaruar deri në fund. 1-Komisioni për dhënie në shfrytëzim të pronës dhe objekteve është zgjedhë nga Kuvendi, 2-Komisioni për ankesa po ashtu është zgjedhë nga Kuvendi dhe, 3-Komisioni për Komitetet konsultative dhe

Komisioni për emërtimin e rrugëve kanë dalë nga një bashkëpunim nga shefat e Grupeve LDK-së dhe PDK-së dhe kjo përbërje të jep për të kuptuar se ka interesa dhe ndikime politike. E theksoi kolegu, por e kam thënë edhe dje në mbledhjen e KPF-së se ka ankesa të shumta. Disa prej tyre punojnë në arsim dhe janë anëtarë të partive politike. Urdhëroni përmes telefonave në profilet e tyre shihni se si marrin pjesë nëpër tubimet e partive politike. Prandaj vërejtja jonë është në këtë drejtim, mirëpo ne jemi për t'i ngritur këto Komisione, por përbërja e tyre të jetë jo politike.

Sa i përket asaj që u tha dje në KPF por edhe sot në këtë mbledhje se ka kandidatë të cilët nuk ka folur, si të flasin kur e dinë se nuk mund të kalojnë.

z.Mirsad Kamerolli, theksoi, i drejtohem parafolësit, z.Haki, që është politike ne e dimë se gjithçka është politike dhe se asgjë nuk është më politike tek ne se sa tek ju.

z.Lutfi Rexhepi, theksoi, unë sinqerisht nuk mund ta kuptoj se pse e gjithë kjo zhurmë për një hiq gjë sepse fundja këta anëtarë të Komiteteve që tash do të zgjedhën vetëm brenda mandatit të Kuvendit dhe ata nuk ka mundësi të zgjedhën për mandat 4 vjeçar, mund të zgjedhën vetëm gjatë mandatit të këtij Kuvendi dhe nuk mund të zgjedhën për mandat të Asamblesë së ardhshme. Ne nuk mund t'i japim dikujt mandat më shumë apo më gjatë se sa që ne e kemi, se fundja është praktikë e përhershme që ne gjithmonë kemi pasur komitetet me letra dhe komisione të ngritura për të shitur mend dhe për të gënjyer më shumë elektoratin kinse se ne përkujdesemi për të gjitha fushat, mirëpo asnjëherë nuk janë konstituuar përveç dy Komiteteve obligative që janë, andaj ju lutemi na kurseni kohën dhe të kalojmë këtë propozim, meqenëse është edhe kërkesë e OSBE-së.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, para se ta hedhim në votim desha të jap një sqarim, brenda këtij mandati na kanë mbetur të mbajmë vetëm edhe dy mbledhje, të bëjmë ndonjë ndryshim tani, sikurse pati kërkuar para disa ditëve z.Nexhat Llumnica, unë kam shfletuar përbërjet e Komiteteve dhe kam hasur që në shumicën prej tyre ka qenë vendi i lirë për përfaqësim të subjektit politik AAK dhe që sot nëse dëshironi, janë tri Komitete dhe nëse e shihni në interes që të propozohen anëtarët atëherë e bëjmë.

Për komitetet në fjalë është Udhëzimi Administrativ përkatës ai i cili rregullon në mënyrë të qartë të gjitha çështjet, dhe në këtë drejtim kemi pas angazhim të veçantë edhe nga ana e OSBE-së ku ne si Kuvend disa herë kemi marrë vendime për shpalljen e konkursit për funksionalizimin e këtyre Komiteteve, mirëpo nuk ka pas të interesuar, nuk kanë konkurruar dhe është anuluar, pasi që kanë konkurruar 1 apo 2 kandidat. Në Udhëzimin Administrativ të fundit specifikohet se anëtarët e komiteteve konsultative kompensohen për takimet e mbajtura, jo më shumë se për 6 mbledhje brenda vitit.

E hedh në votim propozimin e Komisionit për Komitetet konsultative.

Pas votimit u konstatua se me 20 vota për, 3 vota kundër, të tjerët të përmbajtur, u miratua propozimi i Vendimit për miratimin e përbërjeve të Komiteteve Konsultative

5. Propozim vendimi për mbështetje financiare Teatrin Publik të Qytetit "Avdush Hasani" në Podujevë

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sigurisht që e keni analizuar këtë propozim vendim ku i njëjti ka të bëjë me mbështetje financiare Teatrin e qytetit. Mbështetja financiare bëhet nga kategoria e subvencioneve dhe për qëllim ka realizimin e programeve teatrale të parapara nga organet e Teatrit. Andaj nëse nuk ka këshilltarë të lajmëruar për të marrë fjalën, unë e hedh në votim.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua propozimi i vendimit për mbështetje financiare Teatrin Publik të qytetit "Avdush Hasani" në Podujevë

6. Propozim vendimi për vënien në diskutim publik të ndryshimeve të Planit Rregullues të Hollësishëm – Zona Qendër në Podujevë

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, konsideroj se edhe ky propozim vendim është analizuar nga këshilltarët e Kuvendit. Është propozim i cili ka për qëllim vënien në diskutim publik të Planit Rregullues të Hollësishëm – Zona Qendër. Gjithashtu është paraparë kohëzgjatja e diskutimit publik dhe data e mbajtjes së debatit publik me qytetarë dhe në këtë aspekt ju ftoj të gjithëve të merrni pjesë në këtë debat dhe të jeni aktiv në dhënie e propozimeve, sugjerimeve ose vërejtjeve eventuale që mund t'i keni. Vlen të theksohet se ky dokument pas diskutimit publik sërish do të sjellët në Kuvend për shqyrtim dhe miratim final, mirëpo si do që të jetë unë e hapi debatin nëse ka këshilltarë të lajmëruar për të marrë fjalën, nëse jo e hedh në votim.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua propozimi i vendimit për vënie në diskutim publik të ndryshimeve të Planit Rregullues të Hollësishëm – Zona Qendër në Podujevë

7. Të ndryshme

Nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi mbledhjen të përfunduar.

Mbledhja përfundoi në orën 11:35

**Procesverbalin e mbajti
Sabedin Namani**

**Nr.01-060/04-0047679/17
Podujevë,
30 qershor 2017**

**Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi**